

DITARI MUJOR

Tetor, 2024/ Vol. 008

FOOD INGREDIENTS NORTH AMERICA 2024, LAS VEGAS USA

Shqipëria mori pjesë për herë të parë në "Panairin e Përbërësve të Ushqimit" të Amerikës së Veriut në datat 30-31 Tetor 2024. Ky event u realizua në bashkëpunim me ITC (International Trade Centre) dhe SIPPO Albania. Eventi i këtij viti në Las Vegas shënoi një moment të rëndësishëm për agrobizneset shqiptare, ku 8 kompani të vogla dhe të mesme të sektorit të bimëve medicinale dhe aromatike, si dhe vajit të ullirit, prezantuan produktet e tyre në para më shumë se 18,500 profesionistëve të industrisë nga e gjithë bota.

Panairi i FI North America është një nga ngjarjet më të mëdha të vitit për industrinë ushqimore që mbledhi bashkë profesionistë dhe kompani nga mbarë bota. Bazuar në deklaratat e kompanive pjesëmarrëse, nga 460 takime që u realizuan, pritet që rreth 8-10% e kontakteve të krijuara të përkthehen në finalizim kontratash, brenda vitit!



INVESTOR SUPPORT DAYS

AIDA zhvilloi takime me investitorë të huaj që shprehën interesin për të qenë partnerë të investimit në Shqipëri! Mbështetja dhe ndërmarrja e hapave të mëdha për të tërhequr kapitalin e huaj vijon të mbetet misioni ynë kryesor, duke kontribuar në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit!



INVESTOR SUPPORT DAYS

Your Success, Our Ongoing Commitment

OCTOBER - NOVEMBER 2024

GERMAN INVESTOR SUPPORT DAYS

Nisma Investor Support Day nisi me një takim që bashkoi investorët gjermanë ku ata shprehën hapur interesin për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet bizneseve dhe institucioneve shqiptare drejt përmirësimit të investimeve. Së bashku me Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, Z. Arbjan Mazniku, dhe Zëvendës Ambasadorin e Gjermanisë, Z. Thilo Schroeter nënvizuam rëndësinë e vazhdimin të mbështetjes për investimet gjermane në Shqipëri. Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, theksoi rolin e AIDA-s në lehtësimin e këtyre proceseve dhe forcimin e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet dy vendeve.



ITALIAN INVESTOR SUPPORT DAYS

AIDA vijoi me investorët italianë, për të diskutuar sfidat dhe mundësitë me të cilat ata ndeshen në Shqipëri. Në fokus të këtij takimi ishte bashkëbisedimi me investorët ku ata shprehën sugjerimet dhe orientimin se ku mund të adresonin për çështje të rëndësishme drejt përmirësimit të klimës së investimeve. Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, bëri me dije të pranishmit se shumë shpejt AIDA do të ofrojë një aplikacion mobile të dedikuar për investorët ekzistues në Shqipëri. Ndërsa ministri Z. Blendi Gonxhja, siguroi për investorët përpjekjet maksimale nga MEKI për të forcuar bashkëpunimin ekonomik mes dy vendeve.



TURKIE INVESTOR SUPPORT DAYS

Në ambientet e AIDA-s, u dedikua takimi i radhës në kuadër të nismës Investors Support Days me investorët turq në Shqipëri. Në këtë aktivitet ishin pjesëmarrës përfaqësues nga MUSIAD Albania, AIC (Albanian Investment Construction), AKPA (Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive), AKBN (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore), Ambasada Turke si dhe Ministria e Financës. Znj. Laura Saro, Drejtore Ekzekutive e AIDA-s, shprehu gadishmërinë për të forcuar bashkëpunimin me investorët turq që operojnë në Shqipëri. Turqia renditet në vendin e 5-të për investimet e huaja në vendin tonë.



GREEK INVESTOR SUPPORT DAYS

Në ambientet e AIDA-s, u dedikua takimi i radhës në kuadër të nismës Investors Support Days me investorët turq në Shqipëri. Në këtë aktivitet ishin pjesëmarrës përfaqësues nga MUSIAD Albania, AIC (Albanian Investment Construction), AKPA (Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive), AKBN (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore), Ambasada Turke si dhe Ministria e Financës. Znj. Laura Saro, Drejtore Ekzekutive e AIDA-s, shprehu gadishmërinë për të forcuar bashkëpunimin me investorët turq që operojnë në Shqipëri. Turqia renditet në vendin e 5-të për investimet e huaja në vendin tonë.

“Angel Investors” dhe “Venture Capitalist” një ditë para eventit të madh u mirëprit nga AIDA

AIDA si një partner i Tirana Slush'D, mirëpriti së bashku me z. Sokol Duma, Zëvendësministër i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe znj. Elira Kokona, Drejtoreshë Ekzekutive e Korporatës Shqiptare të Investimeve, “Angel Investors” dhe “Venture Capitalist” një ditë para eventit të madh. Znj. Laura Saro, Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, prezantoi përmirësimin e klimës së investimeve dhe mundësitë që ofron Shqipëria për të bërë biznes, duke iu përgjigjur dhe pyetjeve të të pranishmëve.



TIRANA SLUSH'D

AIDA mori pjesë në eventin fantastik “Tirana Slush'D”, që u zhvillua tek Piramida e Tiranës në dt.25 Tetor 2024. Gjatë eventit u prezantuan raste suksesi dhe ide inovative nga folës të njohur, përfshirë z. Peter Vesterbacka dhe z. Walid O. El Cheikh. Znj. Laura Saro, Drejtoreshë Ekzekutive e AIDA, theksoi angazhimin për inovacion dhe përmirësimin e klimës së investimeve në Shqipëri, duke siguruar se AIDA është partneri juaj për t’ju mbështetur me investimin në Shqipëri.



 Lexo më shumë



AIDA mblodhi në tryezë aktorët më të rëndësishëm lidhur me turizmin në Shqipëri

Znj. Laura Saro, Drejtor Ekzekutiv i AIDA-s, prezantoi përmirësimin e klimës së turizmit në Shqipëri dhe mundësitë apo pengesat që përballet ky sektor duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit midis institucioneve dhe biznesit për të promovuar turizmin në Shqipëri. Qeveria ka ndërmarrë një sërë reformash në kuadër të përmirësimit të klimës së turizmit nëpërmjet rritjes së investimeve vendase dhe të huaja si dhe rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike dhe financiare të vendit.



AIDA SHPALL FITUESIT E “FONDIT 2024”

AIDA organizoi eventin për shpalljen e 100 fituesve të Fondit 2024 duke prezantuar publikisht përfituesit dhe projektet e tyre innovative. Në këtë aktivitet u theksua se AIDA do të jetë në gadishmërinë për të lehtësuar apo qartësuar gjithë procedurat e implementimit të projekteve nga përfituesit. Ky event shënon një hap të rëndësishëm në përmbushjen e misionit për të rritur zhvillimin ekonomik dhe fuqizimin e NMVM-ve.



Forumi Ekonomik Shqipëri-Greqi

AIDA organizoi eventin për shpalljen e 100 fituesve të Fondit 2024 duke prezantuar publikisht përfituesit dhe projektet e tyre innovative. Në këtë aktivitet u theksua se AIDA do të jetë në gadishmërinë për të lehtësuar apo qartësuar gjithë procedurat e implementimit të projekteve nga përfituesit. Ky event shënon një hap të rëndësishëm në përmbushjen e misionit për të rritur zhvillimin ekonomik dhe fuqizimin e NMVM-ve.



AIDA mikpritë në takim Ambasadorin e Katarit

AIDA organizoi një takim ku znj. Laura Saro mirëpriti në takim Sh.T.Z. Jabor Ali Hussein Al Dosari, Ambasadorin e Katarit në Shqipëri. Qëllimi i takimit ishte diskutimi i mundësive për forcimin e marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare mes Shqipërisë dhe Katarit. Znj. Saro theksoi mundësinë për tërheqjen e investimeve nga Katarit në sektorë të rëndësishëm, ndërsa ambasadori shprehu interes për projekte të mëdha që do të sjellin përfitime të ndërsjella.



GLOBAL ALBANIAN GASTRONOMY FESTIVAL

AIDA mosi pjesë në Global Albanian Gastronomy Festival duke mbështetur 5 kompani shqiptare në prezantimin e produkteve autentike dhe duke vënë theksin tek cilësia dhe traditat tona. Ky event shënoi një hap të rëndësishëm për promovimin e produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare. Kompanitë pjesëmarrëse prezantuan me krenari trashëgiminë gastronomike shqiptare.



AIDA mori pjesë në Panairin e Biznesit që u zhvillua në datën 23 tetor 2024, në Budva, Mal i Zi.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) në kuadër të zbatimit të projektit "Aftësi për punësim të qendrueshëm dhe rritje ekonomike gjithëpërfshirëse në rajonin ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi" financuar nga projekti i Bashkimi Europian "Cross-Border Cooperation Programme Montenegro – Albania 2014–2020, nëpërmjet Instrumentit për Asistencën e Para-Adhimit (IPA II), mori pjesë në Panairin e Biznesit që u zhvillua në datën 23 tetor 2024, në Budva, Mal i Zi.



IHD-të shënojnë rritje në 6-mujorin e parë të vitit 2024

Në gjashtëmujorin e parë të 2024 rezultatet e Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri tregojnë një rritje të qëndrueshme dhe të rëndësishme. IHD-të investimeve të huaja në vend është dominuar nga Turqia e cila ka kontribuar me 19.5% në fluksin total, e ndjekur nga Italia dhe Holanda të cilat kanë kontribuar me 12.4% dhe 8.1% ndaj totalit dhe më pas nga Franca dhe Austria me përkatësisht 7% dhe 6.6%.

